

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
12	Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, burime të mjaftueshme duhet të shpërndahen paraprakisht për të garantuar përgatitje efektive dhe monitorim të pavarur dhe kuptimplotë nga publiku të teknologjive zgjedhore	Progres i Munguar	Aktualisht nuk ka asnjë nismë për mbështetjen e monitorimit dhe vëzhgimit të procesit për përgatitjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në zgjedhje. Është e nevojshme që donatorë të huaj ose edhe KQZ të mbështesin nisma të organizatave të shoqërisë civile, por jo vetëm, që kanë ekspertizë në zbatimin e teknologjise së informacionit për të monitoruar dhe vlerësuar këtë proces.